



Qëndrueshmëria

fillon këtu

NJË UDHËZUES DREJT PRAKTIKAVE TË QËNDRUESHME PËR BIZNESET SHQIPTARE, I FRYMËZUAR NGA SIPËRMARRJET QË MORËN PJESË NË EDICIONIN E PARË TË VLERËSIMIT PËR SIPËRMARRJET E QËNDRUESHME (SDG BUSINESS PIONEERS AWARD)



INFORMACION RRETH VLERËSIMIT PËR SIPËRMARRJET
E QËNDRUESHME (SDG BUSINESS PIONEERS AWARD)

03

FRYMËZIM PËR PRAKTIKA TË QËNDRUESHME
NË SIPËRMARRJEN TUAJ

04

TRE HAPA DREJT QËNDRUESHMËRISË


13

SIPËRMARRJET QË APLIKUAN NË VITIN 2023

14

BURIME INFORMACIONI PËR SIPËRMARRJEN TUAJ

15



INFORMACION RRETH VLERËSIMIT PËR SIPËRMARRJET E QËNDRUESHME (SDG BUSINESS PIONEERS AWARD)

Vlerësimi për Sipërmarrjet e Qëndrueshme (SDG Business Pioneers Award) është një konkurs kombëtar i hapur për të gjitha sipërmarrjet që operojnë në Shqipëri, pavarësisht madhësisë apo sektorit ku zhvillojnë aktivitetin e tyre tregëtar.

Ky konkurs vlerëson sipërmarrjet që tregojnë një angazhim të veçantë ndaj qëndrueshmërisë dhe që kontribuojnë aktivisht në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-ve). Në çdo edicion, ne kërkojmë bizneset pioniere në arritjen e SDG-ve në Shqipëri, pra sipërmarrjet që nxisin ndryshimin pozitiv përmes praktikave, produkteve, shërbimeve dhe veprimtarive të tyre.

Duke iu bashkuar komunitetit tonë të pionierëve të qëndrueshmërisë, sipërmarrja juaj do të bëhet pjesë e një rrjeti në zhvillim biznesesh, i cili fokusohet në krijimin e një ndikimi pozitiv social dhe mjedisor afatgjatë.


FRYMËZIM PËR PRAKTIKA TË QËNDRUESHME NË SIPËRMARRJEN TUAJ

Sipërmarrjet që aplikuan në "SDG Business Pioneers Award 2023" dhanë shembuj të jashtëzakonshëm të lidershit të biznesit në arritjen e qëndrueshmërisë. Ne besojmë se mënyra më e mirë për të mësuar është duke dhënë shembuj të sipërmarrjeve të tjera dhe për këtë arsye, kemi përzgjedhur për ju praktikatat më të mira të biznesit që kanë zbatuar këto sipërmarrje gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre të biznesit.

Shpresojmë se këto praktika do ju japin frymëzim dhe njohuri praktike për të nisur apo për të vijuar rrugëtimin tuaj drejt qëndrueshmërisë. Presim me padurim që t'ju shohim të bëheni një aktor i ndryshimit pozitiv në Shqipëri.

Praktikat më të mira të qëndrueshme nga edicioni i 1-rë i "SDG Business Pioneers Award" janë kategorizuar në pesë fusha ndikimi:

- Qëndrueshmëria në aktivitetin kryesor të biznesit dhe veprimtarive tuaja
- Për punonjësit: të drejtat, diversiteti, përfshirja dhe të nxëniet
- Bërja e ndryshimit për komunitetin vendas
- Mbrojtja e mjedisit dhe lufta kundër ndryshimeve klimatike
- Partneritetet për të arritur progres në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.





SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS




Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) përfshijnë 17 objektiva globalë të miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 2015, të cilat krijojnë një udhërrëfyes për të trajtuar sfidat më kritike sociale, ekonomike dhe mjedisore në botë. SDG-të ofrojnë një kuadër gjithëpërfshirës për qeveritë, organizatat dhe individët për të bashkëpunuar, për të mobilizuar burimet, si dhe për të punuar drejt një të ardhmeje më gjithëpërfshirëse, të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë.


QËNDRUESHMËRIA NË AKTIVITETIN KRYESOR TË BIZNESIT DHE VEPRIMTARIVE TUAJA

Sipërmarrjet i kanë përdorur këto praktika për të përmirësuar mënyrën se si menaxhojnë lëndët e para, energjinë, ujin dhe mbetjet, me qëllim zvogëlimin e ndikimit të tyre në mjedis.



- Reduktimi i konsumit të letrës, për shembull, falë menaxhimit më të mirë dhe përdorimit të aplikacioneve të nënshkrimit online.
- Reduktimi ose eliminimi i përdorimit të mallrave njëpërdorimshe, për shembull, duke zëvendësuar gotat plastike me filxhanë të ripërdorshëm në të cilët është stampuar mesazhi “redukto, ripërdor, riciklo”.
- Reduktimi i materialeve të printuara, për shembull, në masën 60% brenda një viti.
- Riciklimi i letrës nga mbetjet e paketimit të produkteve, për shembull, sasia në ton e letrës së ricikluar çdo vit.
- Përdorimi i paketimeve të transportit 100% të riciklueshme.
- Menaxhimi i mbetjeve sipas standardeve të HACCP-së dhe GMP-së, me procedura të veçanta dhe të dokumentuara për hedhjen e ushqimit, plastikës, xhamit dhe mbetjeve të riciklueshme të aluminit.



- 
- Plotësimi i nevojave për energji elektrike përmes përdorimit të energjisë së rinovueshme, për shembull, 80% e energjisë elektrike e prodhuar nga panelet diellore.
 - Reduktimi i konsumit të energjisë elektrike duke nxitur efikasitetin e energjisë përmes llambave LED ose ndriçimit natyral, fikjes së pajisjeve dhe investimit në makineri efikente.
 - Inkurajimi i individëve, komuniteteve dhe bizneseve për të qëndruar një orë “pa drita” gjatë vitit me qëllim kursimin e energjisë.
 - Zëvendësimi i flotës së makinave të një korporate me mjete elektrike, për shembull, përmes caktimit të një objekti vjetor.
 - Nënshkrimi i kontratave me furnitorët në përputhje me kodin e etikës dhe praktikën më të mirë, si dhe dhënia e kontributit për të rritur ndërgjegjësimin e tyre rreth çështjeve mjedisore dhe sociale.
 - Përzgjedhja e furnitorëve dhe partnerëve në nivel vendor për të shkurtuar zinxhirin e furnizimit.
 - Përdorimi i materialeve organike dhe të qëndrueshme gjatë prodhimit, për shembull, konsumimi ose prodhimi i frutave dhe perimeve organike (bio).
 - Krijimi i produkteve me materiale të tretshme ose të riciklueshme për të minimizuar ndotjen nga plastika dhe dioksidi i karbonit.

PËR PUNONJËSIT: TË DREJTAT, DIVERSITETI, PËRFSHIRJA DHE TË NXËNIT

Sipërmarrjet e qëndrueshme kanë ambicien për të krijuar një mjedis të larmishëm dhe gjithëpërfshirës në vendin e punës, si dhe kontribuojnë në mënyrë pozitive në jetët e punonjësve dhe të familjeve të tyre. Në vijim jepen disa prej iniciativave ku këto sipërmarrje kanë arritur progres.





- Zhvillimi i iniciativave të diversitetit dhe gjithëpërfshirjes me fokus gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, për të mbështetur ngritjen e tyre në karrierë.
- Krijimi i partneriteteve me projektet për të rinjtë me qëllim rritjen e aftësive profesionale dhe të aftësive për zhvillimin e karrierës së të rinjve.
- Publikimi i vendeve të lira të punës, të cilat ofrojnë mundësi gjithëpërfshirëse, si dhe krijimi i kanaleve të larmishme të rekrutimit, duke përfshirë rrejet profesionale dhe bordet e punës të posaçme për gratë.
- Kultivimi i një fuqie punëtore gjithëpërfshirëse, duke eliminuar në mënyrë aktive kriteret paragjyqese të punësimit të lidhura me gjininë, moshën, prejardhjen, orientimin seksual ose fetar, për shembull, përmes përfshirjes së grave dhe anëtarëve të komunitetit rom.
- Vendosja e fokusit në rekrutimin e individëve me aftësi të kufizuara dhe të grupeve minoritare gjatë pjesëmarrjes në panairët e punës.
- Garantimi i aksesueshmërisë së plotë në vendin e punës, qoftë fizike apo dixhitale, për punonjësit me aftësi të kufizuara.
- Prioritizimi i diversitetit gjinor nga drejtuesit e lartë.
- Përfshirja në planet afatgjatë e objektivave të lidhura me gratë në pozicione drejtuese.
- Krijimi i programeve për të mbështetur individët për t'u rikthyer në tregun e punës pas shkëputjeve në karrierë.
- Garantimi i përfitimeve dhe lejeve të përshtatshme për punonjësit, duke përfshirë lejen për arsye shëndetësore dhe lejen e lindjes.

BËRJA E NDRYSHIMIT PËR KOMUNITETIN VENDAS

Sipërmarrjet që kontribuojnë në komunitetet e tyre mund të ndihmojnë në avancimin e këtyre iniciativave frymëzuese.

- Organizimi i programeve të mentorimit dhe trajnimit për të rinjtë në komunitetet vendore, duke përfshirë panairët e punës, kurset dhe certifikimet për zotërimin e aftësive për t'u bërë pjesë e tregut të punës.
- Dhurimi i një përqindjeje të fitimeve për OJQ-të vendore të angazhuara në trajtimin e sfidave në komunitet dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për grupet e marginalizuara.
- Organizimi i eventeve në komunitet me lektorë, artistë, shkencëtarë dhe persona novatorë për të advokuar mbi qëndrueshmërinë dhe për të nxitur entuziazmin e komunitetit.
- Dhënia e kontributit në iniciativat e mbledhjes së fondeve për kauza emergjente në nivel vendor, si përpjekjet për lehtësimin e pasojave të tërmeteve.
- Dhënia e bursave për studentët e komuniteteve vendase për të mbështetur arsimimin e tyre.
- Projekte për rinovimin dhe ndërtimin e kopshteve dhe parqeve të lojërave në nivel vendor, nga të cilat do të përfitojnë fëmijët në komunitetet vendase.






- Ofrimi i shërbimeve këshillimore falas për fermerët dhe sipërmarrësit mbi praktikat më të mira, veçanërisht mbi ato që zvogëlojnë ndikimin mjedisor.
- Ofrimi i mbështetjes për familjet në krizë, si p.sh. dhurimi i orendive dhe pajisjeve pas shkatërrimit të një shtëpie nga zjarri.
- Sponsorizimi i eventeve kulturore për ndikimin pozitiv, për shembull, vënia në skenë e një pjese teatrale nga të rinjtë me autizëm.
- Dhënia e çmimeve për ndikimin social për sipërmarrësit e shquar, duke njohur kontributet për një shoqëri më të mirë.
- Organizimi i fushatave edukative për praktikat e përgjegjshme të qëndrueshme.
- Sponsorizimi i iniciativave sportive gjithëpërfshirëse.
- Dhurimi i tabletëve ose kompjuterëve për fëmijët në nevojë me qëllim krijimin e mundësive të të nxënimit online.
- Prioritizimi i mundësive të punësimit për individët nga komunitetet vendase.
- Dhënia e kontributit në mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave vendore historike dhe kulturore.



MBROJTJA E MJEDISIT DHE LUFTA KUNDËR NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Sipërmarrjet mund të kenë një rol të fuqishëm në mbrojtjen e mjedisit dhe në dhënien e kontributit për të luftuar ndryshimet klimatike. Ja disa mënyra se si mund ta realizojnë diçka të tillë.



- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve ekologjike.
- Minimizimi i gjurmës mjedisore përmes përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe sistemeve të trajtimit të ujërave nëntokësore.
- Promovimi i veprimtarive të ruajtjes së mjedisit, ku përfshihet efienca e energjisë, menaxhimi i mbetjeve, promovimi i transportit të gjelbër dhe fushatat e ndërgjegjësimit të punonjësve.
- Mbjellja e pemëve në hapësira publike.
- Mosdhënia e huave për projektet që përfshijnë shpyllëzim.
- Pjesëmarrja në financimin e projekteve të energjisë së rinovueshme.
- Marrja e një certifikate vjetore për zvogëlimin e shkarkimeve të karbonit.
- Ndërmarrja e angazhimit për të arritur objektivin “zero emetime neto të karbonit” brenda një viti të caktuar.
- Zbatimi i një plani veprimi për të arritur objektivin “zero emetime neto të karbonit”, ku të përfshihet, për shembull, përdorimi i energjisë së rinovueshme, flota e mjeteve elektrike dhe raportimi mbi qëndrueshmërinë.
- Dhurimi i një përqindjeje të fitimeve për OJQ-të vendore të angazhuara në ruajtjen e mjedisit, si dhe në projektet për mbrojtjen e lumenjve dhe të biodiversitetit.

PARTNERITETET PËR TË ARRITUR PROGRES NË OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Përshkallëzimi i ndikimit është i vështirë nëse jeni vetëm. Krijoni partneritetet me aktorët në nivel vendor për të arritur ndikim të konsiderueshëm, duke marrë frymëzim nga "SDG Business Pioneers Award"!



- Krijimi i partneritetit me Kryqin e Kuq Shqiptar për të ndihmuar fëmijët që kanë nevojë për dhurim gjaku.
- Krijimi i partneritetit me Caritas për të dhuruar veshje dhe ndihma për fëmijët nga familjet në nevojë.
- Krijimi i partneriteteve me bashkitë për të dhuruar pemë për hapësirat publike.
- Krijimi i partneritetit me Food Bank Albania për të mbështetur familjet në nevojë përmes dhurimit të ushqimeve.
- Bashkëpunimi me OJQ-të duke mbështetur iniciativat e vazhdueshme të punësimit për personat me aftësi të kufizuara dhe grupet minoritare.
- Krijimi i partneriteteve me OJQ-të për të ofruar shërbime falas në komunitetet e pambuluara, duke përfshirë ato në fushën e kujdesit shëndetësor dhe dentar.
- Dhënia e ndihmës për viktimat e dhunës në familje, në bashkëpunim me OJQ-të ose organizatat ndërkombëtare.
- Dhënia e mbështetjes për zhvillimin e rrjeteve globale për pjesëmarrjen e grave dhe të minoriteteve në shoqëri.
- Krijimi i partneritetit me WWF-në për të zvogëluar shkarkimet, për të eliminuar mbetjet elektronike dhe elektrike, si dhe për të nxitur një ekonomi qarkulluese për produktet e prodhuara.

TRE HAPA DREJT QËNDRUESHMËRISË

Duke qenë se tashmë keni disa ide të praktikave të qëndrueshme që mund të zbatoni, le të shohim tre hapat që mund të ndërmerri për t'i integruar këto praktika në sipërmarrjen tuaj.

1 Matja

Pasi të keni identifikuar fushat kyçe të qëndrueshmërisë që dëshironi të përmirësoni në sipërmarrjen tuaj, identifikoni treguesit që ju ndihmojnë të gjurmoni ecurinë tuaj. Në vijim jepen disa shembuj nga kjo broshurë: % e energjisë elektrike të kursyer krahasuar me vitin e mëparshëm, % e materialeve të qëndrueshme të përdorura në prodhim, sasia në ton e letrës së ricikluar çdo vit etj.

2 Raportimi

Hapi i dytë është raportimi. Pasi të keni identifikuar treguesit e matjes, integrojini ato në raporte që do të kristalizojnë praktikën e qëndrueshme që zbatoni aktualisht. Nëse përditësohen rregullisht (zakonisht një herë në 6 muaj ose në një vit), këto dokumente do t'ju krijojnë mundësinë të gjurmoni ecurinë tuaj gjatë kohës dhe t'ua prezantoni këtë ecuri klientëve tuaj dhe grupeve përkatëse të interesit. Gjithashtu, mund t'i përdorni këto dokumente për të përcaktuar objektivat tuaj të ardhshëm të lidhur me qëndrueshmërinë.

3 Përmirësimi

Tanimë është koha për të punuar me sipërmarrjen tuaj, për të përmirësuar proceset dhe për të zbatuar praktika të reja të qëndrueshmërisë. Siç mund ta shihni më sipër, nuk ka një kufi të ndikimit pozitiv që mund të arrihet: duke filluar nga krijimi i partneriteteve me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare e deri te përmirësimi i makinerive dhe marrëdhënieve me punonjësit dhe furnitorët. Çdo hap i vogël është i rëndësishëm në arritjen e objektivave tuaj afatgjatë. Pasi të keni bërë përmirësime, kthehuni në hapin 1 dhe masni rezultatet e reja të arritura.

SIPËRMARRJET QË APLIKUAN NË VITIN 2023 PËR VLERËSIMIN PËR SIPËRMARRJET E QËNDRUESHME (SDG BUSINESS PIONEERS AWARD)



BURIME INFORMACIONI PËR SIPËRMARRJEN TUAJ

[Take Action | UN Global Compact \(Marrja e veprimeve | UN Global Compact\)](#)

[Sustainable Development Goals | United Nations Development Programme
\(Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim\)](#)

[GRI - Reporting support \(GRI - Mbështetje për raportimin\)](#)

[Big shifts, small steps - KPMG Albania
\(Transformime të mëdha, hapa të vegjël - KPMG Albania\)](#)



Kjo broshurë është përgatitur në kuadër të projektit të përbashkët të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "[Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për SDG-të](#)", i financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe i zbatuar nga UNDP, FAO, ILO dhe UNIDO në Shqipëri.